

Njoftim punimesh



Punime rrugore të mëdha në gusht dhe shtator

Barrierat janë hequr në linjat Cranbourne dhe Pakenham dhe trenat kalojnë nëpër tunelin Metro. Po vazhdojmë të ndërtojmë një rrugë të re nën linjën hekurudhore, që lidh rrugën Princes Highway-Lonsdale me rrugët Cheltenham dhe Hammond. Nënkalimi rrugor i ri do të hapet në fund të shtatorit, dy vjet para afatit të parashikuar.

Çfarë po bëjmë?

Në **gusht dhe shtator** do të përfundojmë punime rrugore të mëdha për të lidhur nënkalimin rrugor të ri me rrugën Cheltenham dhe rrugën Princes Highway-Lonsdale.

Për të përfunduar në mënyrë të sigurt punimet, do të mbyllim përkohësisht disa seksione të rrugëve Cheltenham dhe Princes Highway-Lonsdale, hapësira parkimi në parkingun e stacionit Dandenong, kryqëzimin e rrugëve Cheltenham dhe Hammond si edhe rrugët pranë tyre, duke përfshirë korsitë dhe shtigjet e këmbësorëve. Ju lutemi të shihni hartat në faqe.

Çfarë mund të presim?

- Punime **24 orë në ditë në gusht dhe shtator**
- Mund të presim mbylljen e rrugëve, korsive dhe këmbësorëve me devijime dhe menaxhim trafiku
- Mbylljen e përkohshme të hapësirave për automjete
- Rritjen e zhurmës, dridhjeve, automjeteve dhe punëtorëve në zonë. Cisterna uji dhe pastrues rrugorë do të përdoren për të minimizuar pluhurin.

Çdo pronë e prekur nga këto punime do të kontaktohet drejtpërdrejt. Qasja do të sigurohet për bizneset, banorët dhe shërbimet e urgjencës.

Do të bëjmë çdo përpjekje për të përfunduar punimet sipas planit. Megjithatë, datat dhe oraret mund të ndryshojnë.

Ndryshimet në mënyrën se si udhëtoni

Ju lutemi të ndiqni sinjalizimin dhe menaxhimin e trafikut në zonë.



Punime dite



Punime nate



Punime 24-orëshe

Ku?	Kur?	Aktiviteti	Çfarë mund të presim?
Ruga Princes Highway-Lonsdale	Nga ora 19:00, të premten, më 14 gusht, deri në orën 19:00, të dielën, më 16 gusht	Asfaltimi, shënimi i vijave dhe punimet në brezin ndarës	• Mbyllja e rrugëve midis rrugëve Foster dhe 109 Lonsdale. • Qasja do të mbahet në rrugën Lonsdale - Service Road nëpërmjet rrugës Thomas dhe në bizneset midis rrugëve 109 Princes Highway - Lonsdale dhe Webster. • Devijime për këmbësorët në rrugët Foster dhe Webster me qasje për këmbësorët vetëm në rrugën Webster.

levelcrossings.vic.gov.au

1800 105 105 (telefononi në çdo kohë)

levelcrossings@bigbuild.vic.gov.au



Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutemi të telefononi në 9209 0147.



Ju lutemi të na kontaktoni nëse dëshironi këtë informacion në një format të arritshëm. Nëse keni nevojë për ndihmë për shkak të një dëmtimi të dëgjimit ose të të folurit, vizitoni relayservice.gov.au



Ku?	Kur?	Aktiviteti	Çfarë mund të presim?
Rruga Princes Highway–Lonsdale	 Nga ora 09:00 deri në orën 15:00 dhe nga ora 20:00 deri në orën 06:00, nga gushti deri në fund të shtatorit	Ndërtimi i nënkalimit	Mbyllja e herëpashershme të korsive drejt veriut dhe jugut midis rrugëve Foster dhe Webster
Rruga Princes Highway–Lonsdale	 Nga ora 21:00 deri në orën 06:00 çdo natë, të martën 18 gusht dhe të mërkurën 19 gusht	Punime në rrjetin nëntokësor të shërbimeve publike	- Mbyllja drejt veriut midis rrugëve Foster dhe Webster. - Qasja në rrugën Webster do të mbahet para orës 12 të mëngjesit (mesnatës).
Parkingu në Stacionin Dandenong në Rrugën Hammond	 Nga ora 20:00, të premten më 21 gusht deri në orën 5 të mëngjesit, të martën më 22 shtator	Ndërtimi i nënkalimit	Mbyllja e përkohshme e deri në 60 vendeve parkimi. Parkim alternativ do të jetë i disponueshëm në parkingun Carroll Lane. Ju lutemi të kontrolloni sinjalizimin e parkimit për më shumë informacion.
Rruga Station në veri të rrugës Cheltenham	 Nga ora 20:00, të hënë më 24 gusht deri në orën 5 të mëngjesit, të martën më 22 shtator	Qasje alternative në parkingun e Stacionit Dandenong	- Mbyllja e përkohshme e deri në 10 vendeve parkimi në rrugë - Mbyllja e përkohshme e parkimit me zhavorr në anën veriore të Station Street. Parkim alternativ do të jetë i disponueshëm në parkingun Carroll Lane. Ju lutemi të kontrolloni sinjalizimin e parkimit për më shumë informacion.
Kryqëzimi i rrugëve Cheltenham dhe Hammond	 Nga ora 20:00 deri në orën 06:00 çdo natë: - E hënë 24 gusht - E hënë 7 shtator - E martë 8 shtator - E hënë 14 shtator - E martë 15 shtator - E mërkurë 16 shtator - E hënë 21 shtator	Vendosja e bordurave, ndërtimi i trotuarit	- Kryqëzimi mbyllet me devijime në vend. Prisni deri në 15 minuta kohë shtesë udhëtimi. - Qasja për këmbësorët dhe bizneset do të mirëmbahen


Ku?	Kur?	Aktiviteti	Çfarë mund të presim?
Rruga Cheltenham	 Nga ora 20:00, të hënë më 24 gusht deri në orën 5 të mëngjesit, të martën më 22 shtator	Ndërtimi i nënkalimit Heqja e sinjalizimit rrugor të vjetër	- Rruga do të mbyllet midis rrugëve 1 Cheltenham dhe Hammond. - Mbyllja e herëpashershme e korsive midis rrugëve George dhe Station. - Mbyllja e shtegut të këmbësorëve midis Hammond Road dhe Foster Street, devijimi përmes Stacionit Dandenong. - Mbyllja e përkohshme e deri në 10 vendeve parkimi në rrugë midis Carroll Lane dhe Hammond Road. - Do të mbahet qasja në biznese.
Rrugët Cheltenham dhe Hammond.	 Nga ora 20:00, të hënë më 24 gusht deri në orën 05:00 E martë 22 shtator	Ndërtimi i nënkalimit	- Kushtet e ndryshuara të trafikut dhe mbyllja e herëpashershme e korsive. Prisni deri në 15 minuta kohë shtesë udhëtimi. - Mbyllja e përkohshme e deri në gjashtë vendeve parkimi në anën lindore të rrugës Hammond. - Qasja për këmbësorët dhe bizneset do të mirëmbahen.
Kryqëzimi i rrugëve Cheltenham dhe Hammond	 Nga ora 20:00, e mërkurë 9 shtator deri në orën 06:00, e diel 13 shtator	Asfaltimi, shënimi i vijave	- Kryqëzimi mbyllet me devijime në vend. Prisni deri në 15 minuta kohë shtesë udhëtimi. - Qasja për këmbësorët dhe bizneset do të mirëmbahen
Kryqëzimi i rrugëve Cheltenham dhe Hammond	 Nga ora 09:00 deri në orën 15:00: - E hënë 14 shtator - E martë 15 shtator - E mërkurë 16 shtator	Punimet mbi shërbimet publike	- Mbyllje me ndërprerje e kryqëzimit, me devijime në vend. Prisni deri në 15 minuta kohë shtesë udhëtimi. - Qasja për këmbësorët dhe bizneset do të mirëmbahen
Stacionet e autobusëve në rrugën Cheltenham	 Nga ora 20:00, të hënë më 24 gusht deri në orën 06:00 më 25 gusht, Nga ora 20:00, të hënë më 7 shtator deri në orën 05:00, të martën më 22 shtator	Punime rrugore	- Rrugët 857 dhe 901 mbyllja e stacioneve të autobusëve - Keneally Street/Cheltenham Road - Station Street/Cheltenham Road - Planifikoni udhëtimin tuaj në transport.vic.gov.au

Devijime


Rruga Princes Highway-Lonsdale do të mbyllet nga ora 19:00, të premten, më 14 gusht, deri në orën 19:00, të dielën, më 16 gusht



Rruga Cheltenham do të mbyllet nga ora 20:00, të hënë më 24 gusht deri në orën 05:00, të martën më 22 shtator



Kryqëzimi i rrugëve Cheltenham dhe Hammond do të mbyllet – datat dhe oraret mund të gjenden në tabelë në faqet



Më shumë informacion



Skani kodin QR ose vizitoni levelcrossings.vic.gov.au/webster-disruptions për të parë të gjitha ndërprerjet.

Nëse keni ndonjë pyetje ose dëshironi më shumë informacion lidhur me projektin, ju lutemi të dërgoni një email në levelcrossings@bigbuild.vic.gov.au ose të telefononi në **1800 105 105**, 24 orë në ditë.

Për të mësuar më shumë rreth projektit vizitoni levelcrossings.vic.gov.au/webster-street

Regjistrohuni për përditësime me email duke vizituar levelcrossings.vic.gov.au/subscribe dhe nën seksionin **Cranbourne-Pakenham lines**, zgjidhni **rrugën Webster, Dandenong**.